# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-447376**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Danimarka akuzon anijen luftarake ruse se qëlloi fishekzjarrë drejt helikopterit në Baltik |
| ADRESA | `https://tpz.al/danimarka-akuzon-anijen-luftarake-ruse-se-qelloi-fishekzjarre-drejt-helikopterit-ne-baltik-i333030` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 20:43:55 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 20:42:16 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ee4438b2ea9a96aa713dff3ab0f09c9783e2c09a57731a20cf37fdc02484d512` |
| TEKSTI | `12818ef62d6d5232928863b7ed2e61a16fbaf55addf7ddc02d7171dbbc1448fa` |
| PAMJA | `0bcd6a6bd1ca2c1e6fc7b81e1db0e4b513c857496012b5ea4d8532ec35f5ae6f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bc832d8e7ea81e0d5f45f411210c293c13e1f802163d25ae02a48711decdec64` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa0d8cfc8113ea79b7663cf26341788a60de665698217179c4b01fa71930ced4` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bc832d8e7ea81e0d5f45f411210c293c13e1f802163d25ae02a48711decdec64`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA, 15 SEPTEMBER 2026, 22:42

# Danimarka akuzon anijen luftarake ruse se qëlloi fishekzjarrë drejt helikopterit në Baltik

TPZ



Danimarka ka akuzuar një anije luftarake ruse se ka qëlluar dy fishekzjarrë drejt një helikopteri të forcave të saj ajrore në Detin Baltik.

Njëri prej fishekzjarrëve kaloi pranë helikopterit gjatë një operacioni rutinë monitorimi të fregatës ruse. Incidenti ndodhi të hënën pranë Gedserit, ndërsa helikopteri danez Fennec po kryente një operacion fotografik të anijes ruse, e cila ndodhej në ujërat ndërkombëtare.

Forcat e Armatosura Daneze thanë se njëri prej dy fishekzjarrëve të lëshuar drejt helikopterit kaloi shumë pranë tij. Ministri danez i Mbrojtjes, Jeppe Bruus, deklaroi se ekuipazhi i anijes ruse nuk kishte bërë asnjë përpjekje për të komunikuar me helikopterin përpara incidentit.

Ministria e Jashtme daneze e cilësoi ngjarjen si “krejtësisht të papranueshme”, ndërsa autoritetet daneze kanë thirrur ambasadorin rus në Kopenhagë për të kërkuar shpjegime.

Kryeministrja daneze, Mette Frederiksen, e dënoi incidentin si një veprim “të pamatur” dhe tha se sjellja ruse synon të “frikësojë dhe përçajë”.

Ministri i Jashtëm Lars Løkke Rasmussen akuzoi Moskën se po i zhvendos gradualisht kufijtë e asaj që e konsideron sjellje të pranueshme.

“Kjo është diçka që nuk mund ta pranojmë”, deklaroi Rasmussen, duke theksuar rrezikun që veprime të tilla mund të sjellin për sigurinë dhe jetën e personelit ushtarak.

Moska e ka paraqitur incidentin ndryshe. Ambasadori rus në Danimarkë, Vladimir Barbin, tha se Rusia do të hetojë me kujdes rrethanat e incidentit, por akuzoi helikopterët danezë për kryerjen e “manovrave të rrezikshme” pranë anijeve luftarake ruse.

Sipas Barbin, ky nuk ishte incidenti i parë i këtij lloji dhe ai pretendoi se kishte ngritur shqetësime të ngjashme edhe vitin e kaluar.

ide!

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Në Shqipërinë e sotme “revolucioni” ka emrin pjesëmarrje dhe alternativë
Nga Preç Zogaj

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti
Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

Ambasadori rus argumentoi gjithashtu se problemet e komunikimit nuk lidhen me anijet e Marinës Ruse, por me palën daneze.

BOTA / 15 September 2026, 22:14

[Raporti i Pentagonit përplaset me Trumpin: Rezervat amerikane të municioneve përballen me mungesa serioze]

BOTA / 15 September 2026, 20:57

[“Më mbështesni ose jap dorëheqjen” - Merz i vendos “ultimatum” CDU-së pas rezultateve negative]

BOTA / 15 September 2026, 20:35

[Britania e Madhe ofron mbështetje për mbrojtjen ajrore të Arabisë Saudite pas sulmeve Houthi]

BOTA / 15 September 2026, 20:03

[Rusia i përgjigjet Trumpit për armëpushimin energjetik: Deklaratat duhet të përkthehen në veprime]

BOTA / 15 September 2026, 20:00

[Italia nuk heq dorë nga pezullimi i Shengenit/ Spanja kundërpërgjigjet: E panevojshme dhe absurde!]

BOTA / 15 September 2026, 19:29

[Mafiozët italianë organizojnë gara të paligjshme me kuaj në autostradë, gjithçka shoqërohet me të shtëna]

BOTA / 15 September 2026, 18:54

[Tragjedi pas dasmës në Venecia/ Gruaja shtatzënë humb jetën në aksident me

BOTA / 15 September 2026, 18:35

[Panik në Stamboll/ Të shtëna me armë në një dyqan, 3 persona humbin jetën

varkë, bashkëshorti në koma

BOTA / 15 September 2026, 18:00

Përplasje me SHBA-në, por Kanadaja nuk tërhiqet/ Kryeministri: Do të jemi partneri më i mirë

BOTA / 15 September 2026, 17:37

VIDEO/ Pamje dramatike nga Utahi, helikopteri pëson avari në ajër pak sekonda pas ngritjes

BOTA / 15 September 2026, 15:19

Mbrojtja zbulon faturën, 42 mijë euro në gjashtë muaj për çdo ushtarak në Gaza

BOTA / 15 September 2026, 15:02

Bill Gates: Qeveritë në mbarë botën janë shumë prapa në zhvillimet e inteligjencës artificiale

BOTA / 15 September 2026, 14:53

Gjermani/ Pse partitë e konsoliduara po humbasin votuesit migrantë

BOTA / 15 September 2026, 14:34

Trump kundër “frenimit” të Inteligjencës Artificiale: Robotët nuk do ta pushtojnë botën, i vetmi kontroll i nevojshëm është një president i zgjuar

BOTA / 15 September 2026, 10:24

Dyshohet se vinte nga Bjellorusia/ Avionët e NATO-s

BOTA / 15 September 2026, 09:22

Lufta/ Huthët sulmojnë Arabinë Saudite me raketa

rrëzojnë një dron që hyri në hapësirën ajrore të Lituanisë

dhe dronë, rritet frika për përshkallëzim të konfliktit në Lindjen e Mesme

BOTA / 14 September 2026, 21:54

Vance: Kush mashtroi taksapaguesit amerikanë gjatë COVID-19, nuk përfiton më kredi qeveritare

BOTA / 14 September 2026, 21:43

Kërcënimet ruse dhe kineze, 12 vende evropiane kërkojnë që BE-ja të forcojë praninë në Arktik

BOTA / 14 September 2026, 21:04

Gjermania urdhëron ushtarët të shërbejnë në Lituani për shkak të mungesës së vullnetarëve

BOTA / 14 September 2026, 20:25

Rrëzohet avioni në Gjermani, 3 të vdekur

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES NJOFTIME NGA TPZ.AL

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

AKTUALITET
IDE
NË FOKUS
BALLKAN
BOTA
LIFESTYLE
SPORT
TEJ E KETEJ
BLOG
EMISIONE

Built & Monetized by Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.